

POLITIKA FISKALE

Anastas Angjeli
Ministër i Financave

ZHVILLIMI I FINANCAVE PUBLIKE DHE HARMONIZIMI I LEGJISLACIONIT NË KUADRIN E INTEGRIMIT EUROPIAN

Të nderuar pjesëmarrës!

Konferenca që po zhvillojmë sot, përkon me dhjetëvjetorin e anëtarësimit të Shqipërisë në dy nga institucionet financiare ndërkombëtare më prestigjioze, Fondi Monetar Ndërkombëtar dhe Banka Botërore, të krijuara nga marrëveshja e Bretton Wuds -it, në korrik të vitit 1944, në pragun e përfundimit të Luftës së Dytë Botërore, që po shkonte drejt fitores së vendeve të Aleancës Anglo- Sovieto- Amerikane kundër Nazifashizmit.

Dhjetë vjet tranzicion jo i lehtë, dhjetë vjet punë e përpjekje për vendosjen e bazave të ekonomisë së tregut, përmes zbatimit të një kuadri reformash të rëndësishme.

Prandaj, në këtë konferencë nuk mund të mos hedhim sytë, mbi gjendjen e vendit tonë në dhjetor të vitit 1991, në vështrimin politik, ekonomik, financiar e social; në kuadrin e shndërrimeve

demokratike, të reformave ekonomike dhe strukturore; të arritjeve ekonomiko-sociale dhe, veçanërisht, të arritjeve në fushën e financave publike që kemi patur gjatë këtyre dhjetë viteve, në sajë edhe të ndihmës e të kontributit të çmuar të këtyre dy institucioneve ndërkombëtare në të cilat Shqipëria ka aderuar që në vitin 1991.

Viti 1992, shënoi nënshkrimin e marrëveshjes Stand-by, që përbën hapin e parë të madh për institucionalizimin politik të shtetit demokratik pluralist, të kalimit në ekonominë e tregut, të vendosjes së shtetit ligjor dhe të masave për stabilizimin makroekonomik të vendit. Kjo në një kohë kur, gjendja e ekonomisë dhe e financave publike ishte në një krizë të thellë.

Viti 1992 shënonte një rënie ekonomike rreth 35 për qind, në krahasim me vitin 1990, deficitin buxhetor kishte përmasa të larta, inflacioni vjetor kishte arritur 237 për qind, ndërsa rezervat valutore të vendit mbulonin vetëm disa ditë importe.

Sëmundja e inflacionit, rëndonte në mënyrë të ndjeshme dhe rrëronte pjesën më të madhe të popullsisë, të ardhurat reale të të cilës keqësoheshin nga dita në ditë, nga rritja e vazhdueshme e nivelit të çmimeve. Mjafton të shënojmë se në dhjetor të vitit 1992, indeksi i çmimeve të konsumit, që mat shkallën e inflacionit në krahasim me dhjetorin 1990 shënonte 689,9, domethënë niveli i përgjithshëm i çmimeve me pakicë ishte rreth 7 herë më i lartë, krahasuar me vitin 1990, rrjedhoja këto të sistemit diktatorial, të drejtimit të centralizuar të ekonomisë e të mbylljes hermetike për 45 vjet me rradhë.

KONTURET E REFORMËS FISKALE

Krahas shndërrimeve demokratike në fushën politiko-shoqërore, juridike e institucionale që zunë fill me përmbysjen e regjimit diktatorial e të sistemit ekonomik të drejtuar në mënyrë të centralizuar e të planifikuar, siç dihet, edhe në vendin tonë u ndërmoren reforma për kalimin në ekonominë e tregut. Pjesë e pandarë dhe e rëndësishme e këtyre reformave ishin përpjekjet e para për konturimin e një reforme fiskale, zanafilla e të cilës ishte paketa e ligjeve, që filloi të zbatohet nga 1 janari i vitit 1992.

Konturimi i një reforme fiskale nuk ishte një punë e lehtë dhe e thjeshtë, përkundrazi, ishte një ndërmarrje që unë e konsideroj dhe e vlerësoj, sa të vështirë aq edhe komplekse, veçanërisht po të mbahen parasysh kushtet e vendit tonë në atë kohë, siç ishin:

- gjendja e ekonomisë dhe e financave në krizë të thellë në vitet 1991 -1992;
- psikologjia "e kultivuar " për dekada me rradhë se Shqipëria ishte i vetmi vend pa taksa e pa tatime në botë;
- shkalla e kufizuar e njohjes, si në rrafshin teorik ashtu edhe në atë profesional, e kuadrove të organeve vendore, në fushën e ekonomisë së tregut;
- mosnjohja në nivelin e duhur, të thellë, nga ekspertët e huaj, të kushteve konkrete të vendit tonë, si në aspektin e mentalitetit dhe të psikologjisë së popullit shqiptar ashtu edhe në aspektin ekonomik e financiar;
- së fundi, mungesa e kuadrit ligjor adekuat.

Por, me gjithë këto vështirësi, askush nuk mund të mohojë ndihmën, përvojën dhe përkushtimin e ekspertëve të Fondit Monetar Ndërkombëtar e të Bankës Botërore, ndër të cilët unë nuk mund të rri pa evidentuar ndihmën e parë të vyer të zotit Mario Blayer, gjatë fazës së parë të tranzicionit në ekonominë e tregut, kur në vendin tonë u miratua një paketë ligjesh, ndër të cilat dëshiroj të theksoj:

- ligji "Për tatimin mbi fitimin", në janar të vitit 1992, i cili u modifikua dhe u përmirësua në mars të vitit 1993, që konsakronte mënyrën e të tatuarit sipas sistemit dhe tarifave me përqindje proporcionale, që teorikisht dhe praktikisht njihet se ka për synim përkrahjen, nxitjen dhe zhvillimin e veprimtarisë së lirë ekonomike private. Në të njëjtën kohë, ky ligj shpallte dhe barazinë përpara tatimit, të personave fizikë e juridikë të huaj me ata vendas;
- ligji " Për tatimin mbi qarkullimin", si tatim i tërthortë njëfazor që zbatohet për produktin e gatshëm (përfundimtar) që shitej në të tretë, subjekt i të cilit ishin personat fizikë dhe juridikë vendas e të huaj, që prodhonin ose importonin mallra apo kryenin shërbime në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- ligji "Për buxhetin", miratuar në vitin 1992, që ndryshoi në koncept mënyrën e vjetër të hartimit, zbatimit dhe klasifikimit buxhetor, duke patur në bazë shndërrimet thelbësore në ekonomi, si dhe për t' ju përgjigjur më mirë rolit dhe funksioneve të shtetit demokratik pluralist. Aktualisht, kemi kaluar në një proces që siguron parashikimin e burimeve dhe të shpenzimeve për një periudhë trevjeçare;
- ligji " Për investimet e huaja", miratuar në nëntor të vitit 1993, lejonte dhe trajtonte në mënyrë të barabartë dhe të paanshme investimet e huaja me ato vendase, dhe siguronte për to një trajtim jo më pak të favorshëm se ai që u sigurojnë normat,

përgjithësisht të pranuar nga e drejta ndërkombëtare. Gjithashtu, ai përcaktonte shprehimisht se "investimet e huaja nuk do të shtetëzohen dhe as nuk do të shpronësohen, as në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe as të tërthortë".

Zbatimi i kësaj pakete, shërbeu për të siguruar disa arritje si: ndërtimi i një strukture adekuate të të ardhurave dhe shpenzimeve buxhetore, ku spikasin vëllimi dhe pesha specifike e tatimeve dhe e taksave nga popullsia, ulja e deficitit buxhetor në shprehje relative (në raport me PPB-në), hapja e rrugës investitorëve të huaj dhe vendas, pa i lejuar vetes diskriminimin e të huajve, ndërgjegjësimi shkallë-shkallë i popullsisë dhe i biznesit dhe edukimi fiskal i tyre me konceptin se: shteti nuk mund të mbahet në këmbë e të funksionojë pa kontributin e të gjithë shtetasve, në përpjesëtim me të ardhurat që realizojnë nga veprimtaria ekonomike e financiare e tyre, pra, pa paguar tatime dhe taksa, që përbëjnë "një të keqe të domosdoshme" për të përballuar nevojat e përgjithshme të shoqërisë dhe ato kolektive, në formën e shpenzimeve buxhetore për rendin, sigurimin kombëtar, arsimin, shëndetësinë, artin, kulturën dhe shkencën, pa të cilat nuk mund të ketë as shtet.

Në fund të viteve 1995 dhe 1996, në krahasim me vitin 1992, struktura e buxhetit për të ardhurat dhe shpenzimet kishte marrë tashmë një formë dhe përmbajtje të re, e cila deri më sot është përsosur e do të vazhdojë të përsoset, për t'u bërë më funksionale, duke ju përshtatur zhvillimeve të ekonomisë së tregut, burimeve të reja të sigurimit të të ardhurave buxhetore, ashtu edhe destinacionit funksional e sektorial të shpenzimeve. Ndërkaq, inflacioni në fund të vitit 1995 arriti në 6 për qind, kundrejt 16 për qind që ishte një vit më parë.

Këto ishin rezultatet e para të arritura në zbatim të rekomandimeve të Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe të Bankës Botërore, nëpërmjet marrëveshjes stand-by, të nënshkruar në 26 gusht të vitit 1992 dhe që parashikonte një paketë masash paraprake për stabilizimin makroekonomik të vendit dhe që përfshinin pakësimin e deficitit buxhetor, frenimin e inflacionit, liberalizimin e çmimeve, shfuqizimin e monopolit të shtetit mbi tregtinë e jashtme, funksionimin e tregut të lirë, reduktimin e rolit ekonomik të shtetit, reformimin e sistemit bankar me dy nivele, konvertibilitetin e brendshëm të monedhës etj..

PËRSOSJA E MËTEJSHME E REFORMËS NË SISTEMIN E FINANCAVE E PUBLIKE NË PËRGJITHËSI DHE NË ATË FISKAL NË VEÇANTI (1998-2001)

Qeveria e koalicionit Aleanca për Shtetin, që erdhi në pushtet pas shembjes së sistemit piramidial dhe trazirave të marsit të vitit 1997, në kushtet e krijuara, filloi menjëherë të mendojë dhe të parapërgatisë një paketë masash fiskale në nivelin e një reforme duke u udhëhequr nga disa parime dhe rekomandime të Fondit Monetar Ndërkombëtar e të Bankës Botërore si dhe nga një sërë konkluzionesh dhe projektsh, të përpunuara nga Qendra Ndërkombëtare për Zhvillim Ekonomik e San Franciskos, me synim përsosjen e mëtejshme të reformës fiskale dhe të asaj buxhetore, të zbatuara në vendin tonë nga viti 1993 deri në vitin 1996 .

Në këtë kuadër, unë do të ndalem në disa nga parimet kryesore nga të cilat jemi udhëhequr duke patur parasysh gjithmonë edhe përvojën tonë të fituar në këto vite, si dhe kushtet specifike të vendit tonë:

1. Në përputhje me programin dhe filozofinë e qeverisë së re demokratike, si parim bazë ka shërbyer ai i ndërtimit të një sistemi dhe politike fiskale "neutrale", përballë akumulimit dhe shpërndarjes së kapitalit, me synim nga njëra anë për t'i hapur rrugë zhvillimit të iniciativës së lirë private, zhvillimit të prodhimit, të biznesit e të investimeve dhe, nga ana tjetër, për të mundësuar reduktimin e deficitit të buxhetit të shtetit e të sigurimit brenda mundësive të ekulibrit financiar.

Domethënë, në thelb ne jemi përpjekur të ndërtojmë, për kushtet e vendit tonë, një fiskalitet që jo vetëm të mos frenojë prodhimin bujqësor e industrial, por brenda mundësive tona, të përmbajë elemente që nxisin prodhimin në përgjithësi dhe në veçanti, prodhimin e atyre mallrave e degëve tradicionale të industrisë, që me kushtin e avantazheve të krahasuara, të formuluar nga D. Rikardo, mund të bëhen rentabile e pse jo edhe kompetitive. Në të njëjtën kohë, ne mbajtëm parasysh që sistemi ynë fiskal të përmbante "Elasticitetin automatik", të nevojshëm, domethënë, të ketë aftësinë "për të prokuruar ", me shumë të hyra publike, në shërbim të konsolidimit financiar të vendit.

2- Në reformimin e sistemit fiskal ne jemi udhëhequr edhe nga parimi i njohur teorik i universalitetit të tatimeve, sipas të cilit, çdo subjekt që realizon të ardhura nga një veprimtari ekonomike e financiare duhet të kontribuojë në mbulimin e shpenzimeve të përgjithshme të shtetit, në përpjesëtim me të ardhurat që siguron

për të mbuluar nevojat e përgjithshme të shoqërisë, siç janë arsimi, shëndetësia, administrata, rendi e sigurimi kombëtar.

3- Ne kemi mbajtur parasysh, gjithashtu, parimin që sistemi dhe politika jonë financiare buxhetore të mos i kundërvihet rritjes së kursimit kombëtar dhe investimeve vendase e të huaja, por t'i stimulojë ato në bashkërendim edhe me politikën monetare e kredituese.

4- Gjithashtu, kemi mbajtur parasysh mësimin dhe përvojën historike të vendeve të ndryshme të botës, sipas të cilave një sistem fiskal demokratik mund të jetë efikas kur përshkohet edhe nga një disiplinë e rreptë financiare, si në fushën e shpenzimeve buxhetore ashtu edhe në arkëtimin e të ardhurave (nga tatimet dhe taksat), në mënyrë të plotë, në afatet e caktuara, duke respektuar me rigorozitet dispozitat ligjore, me synim reduktimin e evazionit fiskal, të kontrabandës dhe korrupsionit, për të rritur kështu koeficientin e mbledhjes së të ardhurave buxhetore, por pa i lejuar vetes veprime me karakter arbitrar dhe subjektiv në dëm të biznesit apo të çdo tatimpaguesi.

5- Duke patur parasysh orientimin për decentralizimin e pushtetit vendor e të vetëqeverisjes së organeve lokale, kemi programuar zgjerimin shkallë - shkallë të burimeve financiare në përkatësi të bashkive dhe komunave, por me synim që të administrojnë këto burime me disiplinën dhe rregullat e vendosura nga ana e tyre.

6- Kemi marrë në konsideratë edhe parimin e njohur që sistemi fiskal duhet të jetë sa më i thjeshtë dhe sa më pak i kushtueshëm për vendin.

Të ndërgjegjshëm se një sistem fiskal, që të jetë sa më racional, sa më efektiv dhe sa më produktiv duhet të shoqërohet me instrumentet dhe mekanizmat adekuatë, domethënë me disa lloje tatimesh (të drejtpërdrejta e të tërthorta) dhe me një politikë sa më të matur, ne kemi zbatuar kryesisht mënyrën e të tatuarit me tarifa proporcionale dhe kemi shmangur, në maksimumin e mundshëm, tatimin me tarifa progresive dhe regresive.

Gjatë kësaj periudhe, ne kemi përsosur edhe vetë ligjin organik të buxhetit me principet bashkëkohore që përmban ligji në fuqi i vitit 1998, në harmoni edhe me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Duke filluar nga viti 2000, ne kemi bërë një hap tjetër përpara, duke kaluar nga parimi i buxhetit vjetor, në parashikimin e burimeve dhe shpenzimeve, pra një buxhet për një periudhë afatmesme trevjeçare, arritur në mirëkuptim të plotë me Fondin Monetar Nndërkombëtar.

Tashmë janë përfunduar dy dokumente të rëndësishme për forcimin e administrimit të buxhetit të shtetit dhe për zhvillimin ekonomik të vendit. Programi buxhetor afatmesëm 2002-2004, (MTEF) synon forcimin e disiplinës fiskale, duke siguruar planifikimin e shpenzimeve publike brenda një kuadri realist makroekonomik e fiskal dhe do të mundësojë përcaktimin e prioriteteve të shpenzimeve publike, duke lidhur në mënyrë të qartë politikatat e qeverisë me planet e shpenzimeve, do të inkurajojë një efikasitet më të madh teknik në shpërndarjen dhe përdorimin e burimeve buxhetore dhe do të sjellë më shumë mundësi parashikuese në procesin e hartimit të buxhetit, duke lejuar ministrinë të planifikojnë programet e tyre të shpenzimeve në afat të mesëm.

Ndërsa Strategjia e Rritjes Ekonomike dhe Reduktimit të Varfërisë, (GPRS) synon përgatitjen e strategjisë afatmesme të zhvillimit, duke shënuar një nivel të ri cilësor në hartimin e politikave të zhvillimit të vendit dhe të reduktimit të varfërisë. Ky dokument dëshmon atë që Shqipëria ka dalë tashmë nga emergjenca dhe është futur në një etapë të re, në atë të zhvillimit dhe të rritjes së ekonomisë reale.

Pasi parashtrova parimet dhe orientimet bazë, nga të cilat jemi udhëhequr në përsosjen e reformës financiare, më lejoni të parashtroj para këtij auditori të nderuar, edhe disa nga arritjet gjatë viteve të qeverisjes tonë.

	1996	1998	1999	2000	2001 (Plan)
1. Të ardhurat buxhetore					
Gjithsej :	51572	93519	107506	120637	141777
Të ardhura tatimore gjithsej	30174	56749	65402	84060	95500
Nga doganat	16087	36042	36399	48019	52050
Nga tatimet	12717	19987	28118	34726	41850
2. Shpenzime buxhetore					
Gjithsej :	87596	141628	165692	170620	196311
Nga te cilat :					
Shpenzime kapitale	16568	24215	34120	36274	44739
Shpenzime korrente	62458	81521	96634	104774	127814
Shpenzime për interesa	8571	35892	34938	29572	23758

3. Deficiti buxhetor					
Në % ndaj PBB-së	12.8	10.4	11.5	9.3	9.2
Financuar nga burime të brendshme	9.9	6	5.3	3.3	2.6

Paketa fiskale e paraqitur për miratim Kuvendit së bashku me projektbuxhetin e vitit 2002, mbështetet në ato parime bazë mbi të cilat është përsosur reforma e viteve 1998-2000 dhe njëkohësisht synon:

- Të trajtojë në mënyrë sa më të drejtë dhe të barabartë biznesin.
- Të mënjanojë procedurën e zbatuar deri tani, të "tatimit mbi tatim" që ka patur vend deri më tani, me njëfarë ndikimi kufizues në zhvillimin e biznesit.
- Të vërë në zbatim akcizat me kuota fikse për njësi "të mallrave të fortë" që me ligj detyrohen të paguajnë akcizë, duke zbutur disi edhe përdorimin, në ndonjë rast pa vend, të çmimeve të referencës në importet e këtyre mallrave.
- Të reduktojë konkurrencën e pandershme.
- Të zgjerojë bazën e tatueshme dhe të kufizojë veprimet me karakter arbitrar dhe subjektiv, që kanë patur vend në procesin e zbatimit nga ndonjë prej organeve tona tatimore dhe doganore.

Ndërsa në aspektin social, parashikohet rritja e minimumit të patatueshëm, për të ardhurat nga paga, nga 10 mijë lekë në 14 mijë lekë në muaj.

Këto janë masat në prag të marrëveshjes së re PRGF me FMN-në, pas përfundimit me sukses të marrëveshjes trevjeçare ESAF-2.

HARMONIZIMI I LEGJISLACIONIT FINANCIAR NË KUADRIN E INTEGRIMIT EKONOMIK E FINANCIAR NË BASHKIMIN EUROPIAN

Ne jemi të ndërgjegjshëm se sot jetojmë në një bashkësi globale, ku popujt dhe vendet e ndryshme të botës janë të ndërruar nga njëri-tjetri, mbi bazën e kushteve natyrore materiale e shoqërore të punës e të prodhimit. Ky realitet kushtëzon ndarjen ndërkombëtare të punës dhe specializimin, çka ka bërë dhe bën objektivist të nevojshëm zhvillimin e lirë të shkëmbimeve tregëtare, si një nga faktorët për afrimin dhe progresin e popujve, vendeve e rajoneve të botës midis tyre, çka na bën të konkludojmë se periudha historike që po jetojmë është periudha e proceseve integruese, si në Europë ashtu edhe më gjerë, në Amerikë e Azi.

Bashkimi Europian, OECD, NAFTA (North American Free Trade Agreement) ASEAN në Azi e dëshmojnë më së miri procesin integrues në të cilin është futur sot bota.

Zhvillimet ekonomike në vitet që vijuan, aspirata për aderim në BE dhe pranimi në OBT, bënë të domosdoshme përshtatjen dhe përafrimin e legjislacionit doganor shqiptar me atë komunitar. Këtij qëllimi i shërben edhe hartimi i Kodit të Ri Doganor, që u miratua nga Kuvendi i Shqipërisë dhe hyri në fuqi më 15 maj 1999, si dhe Dispozitat Zbatuese të miratuara nga Këshilli i Ministrave, që u përpunuan në bashkëpunim me ekspertët e BE-së dhe të Misionit CAM-A, që është i pranishëm në Shqipëri që nga viti 1997.

Me hyrjen në fuqi të Kodit të Ri Doganor u ristrukturua administrata Doganore dhe u krijuan strukturat për luftën kundër korrupsionit e kontrabandës. Në shtator 1998 filloi të zbatohet procesi i rekrutimit të punonjësve duke zbatuar një sistem transparent punësimi dhe gradimi, nëpërmjet konkurimit të hapur dhe testimit, që përbën edhe modelin e parë i cili u përdor më pas për të gjithë administratën publike.

Tashmë, Administrata Doganore Shqiptare ka "Strategjinë e Zhvillimit" të saj të përpiluar në përputhje me standardet e përcaktuara nga Komisioni Europian, për aderim paraprak, në kuadrin e hapjes së negociatave për Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit.

Përafrimi me legjislacionin europian në fushën fiskale dhe modernizimi i tij, ka filluar që në vitin 1995 e në vazhdim. Në korrik të vitit 1996, pas një viti e gjysmë punë intensive, u implementua në vendin tonë ligji "Për TVSH-në" dhe filloi të zbatohet kompjuterizimi në dy rrethet kryesore të vendit, që konsiderohet si hapi i parë i suksesshëm në drejtim të reformës në administratën tatimore dhe si një kontribut me vlerë i Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe Bankës Botërore, nëpërmjet projekteve të financuara prej tyre.

Cikli i modernizimit të legjislacionit tatimor vazhdoi me miratimin, në dhjetor të vitit 1999, të ligjit "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i cili sanksionoi në mënyrë të qartë, të drejtat dhe detyrat e administratës tatimore, ashtu dhe të tatimpaguesve, me synim për të mënjanuar shfaqjen e arbitraritetit dhe të subjektivitetit. Tashmë, me paketën e re fiskale që është dërguar për miratim në Kuvend (e që do të hyjë në fuqi në janar të vitit 2002) është përsosur më tej, nëpërmjet marrjes në konsideratë

edhe të mendimeve e sugjerimeve të komunitetit të biznesit dhe të investitorëve vendas dhe të huaj.

Po kështu, edhe ligji i "Tatimit mbi të ardhurat", që hyri në fuqi në dhjetor të vitit 1998 dhe që u hartua në bashkëpunim me ekspertë të huaj (anglezë), në përmbajtjen e vet është i nivelit të standardeve komunitare.

Përvoja e përqendrimit të kontrollit financiar tek Kontrolli i Lartë i Shtetit dhe shkrirja e strukturave të kontrollit të brendshëm financiar të ministrive dhe institucioneve shtetërore në vitin 1992, nuk dha rezultatin e duhur. Prandaj, duke marrë parasysh edhe sugjerimet e institucioneve ndërkombëtare, ne vendosëm krijimin e strukturave sa më të pavarura të kontrollit, sanksionuar edhe në Deklaratën e Limës, me synimin për të përcaktuar sa më drejt dhe sa më saktë përgjegjësinë materiale e financiare, e për të parandaluar shkeljet administrative e ligjore, për të rikuperuar dëmet dhe për të parandaluar shpenzimet që kanë akoma vend, të fondeve publike të vëna në dispozicion të institucioneve qendrore dhe të pushtetit vendor, ku duhet pranuar se kemi mjaft dobësi nga mungesa e një pune të kualifikuar të kontroll-revizorëve.

Për t'i prerë rrugën dhe për të parandaluar fenomenin e riciklimit të parave të pista, të vëna në rrugë jo të ligjshme dhe kriminale, në vitin 2000, në vendin tonë ka hyrë në fuqi ligji "Për parandalimin e pastrimit të parave", i cili u hartua me ndihmën e FMN-së. Edhe përmbatja e këtij ligji dhe krijimi i strukturave përkatëse pranë Ministrisë së Financave, që aktualisht emërtohet: "Drejtoria e Bashkërendimit të Luftës Kundër Pastrimit të Parave", është një dëshmi tjetër e përpjekjeve tona për përafrimin e legjislacionit tonë financiar me atë europian, në luftën kundër terrorizmit dhe organizatave terroriste, që disponojnë dhe përdorin kapitale financiare të konsiderueshme, të shpërndara në shumë vende të botës për qëllime kriminale.

Duke njohur rolin dhe rëndësinë e buxhetit të shtetit si instrument për ndërhyrjen e tërthortë në ekonomi, si dhe rëndësinë e politikës fiskale në të hyrat e buxhetit dhe në zhvillimin e ekonomisë së vendit, para nesh mbetet detyrë, përsosja e mëtejshme e legjislacionit në fushën e financave dhe modernizimi, sidomos i administratës tatimore, pasi për Shqipërinë nuk mund të flitet për një barrë të rëndë fiskale. Përkundrazi, barra fiskale në vendin tonë është ndër më të ultat në vendet e Europës Qendrore dhe Lindore, ajo kap shifrat 16 për qind - 17 për qind e PBB-së, ndërsa në

Poloni është 41-43 për qind; në Hungari 39-41 për qind; në Çeki 40-41 për qind etj.

Sfida jonë për të ardhmen është barra parafiskale, që vlerësohet disi e lartë dhe prandaj për vitin 2002, është parashikuar një ulje e saj në masën 4-5 për qind.

PRIVATIZIMI I BANKAVE ME KAPITAL SHTETËROR

Reforma e sistemit bankar është konsideruar si pjesë e pandarë dhe e rëndësishme e tërë reformës ekonomike të vendit, e cila nuk mund të konceptohet pa privatizimin e bankave me kapital shtetëror dhe zhvillimin e sektorit bankar privat në Shqipëri.

Ne ishim të ndërgjegjshëm se sistemi bankar, i drejtuar dhe i mbikëqyrur nga Banka e Shqipërisë si bankë qendrore, do të luante një rol tepër të rëndësishëm për stabilitetin makroekonomik dhe për zhvillimin e ekonomisë së vendit tonë. Procesi i privatizimit të bankave shtetërore, i filluar në vitin 1995 me miratimin e ligjit "Për transformimin e bankave tregtare shtetërore në shoqëri tregtare dhe lejimin e privatizimit të tyre", u pasua më vonë me mjaft akte të tjera ligjore dhe nënligjore. Mungesa e eficiencës së këtyre bankave, sidomos në treguesit e kthyeshmërisë së kredisë, tregoi se hapat fillestarë të ristrukturimit, qenë të pamjaftueshëm. Fillimisht u likujdua Banka Tregtare Agrare, pjesë të aktivitetit të së cilës u transferuan në bankat e tjera shtetërore, ndërsa huatë e këqija u transferuan tek Agjencia e Trajtimit të Kredive. Ky proces, jo vetëm nuk solli ndonjë shqetësim tek depozituesit, por ndikoi në shkurtimin dhe në përshpejtimin e procedurave për dy bankat e tjera, të cilat mbështetur në bazën ligjore, filluan të përgatiten për privatizim.

Formula e përdorur në privatizimin e Bankës Kombëtare Tregtare dhe të Bankës së Kursimeve, synon krahas rritjes së eficiencës së bankave edhe tërheqjen e investitorëve strategjikë, gjë që shpërndan më gjerë pronësinë mbi kapitalin dhe thithjen e kapitalit të huaj. Është kjo arsyeja që, në privatizimin e bankave, përparësi në blerjen e tyre patën dhe kanë investitorët strategjikë institucionalë, që ofrojnë blerjen e më shumë se një të tretës së aksioneve me të drejtë vote, deri në shumicën absolute të aksioneve të bankës.

Tashmë ka përfunduar privatizimi i Bankës Kombëtare Tregtare, që u realizua nëpërmjet zhvillimit të tenderit të hapur ndërkombëtar dhe aksionet e të cilës u blenë nga Kent Bank 60 për qind plus 2

aksione, si dhe nga BERZH-i dhe IFC-ja që blenë nga 20 për qind minus 1 aksion secila.

Privatizimi me sukses i Bankës Kombëtare Tregtare, jo vetëm që zgjeroi hapësirat e kreditimit të ekonomisë së vendit, por krijoi, gjithashtu, një përvojë pozitive për privatizimin e Bankës së Kursimeve.

Në mbështetje të këtij procesi, janë miratuar një sërë aktesh ligjore dhe nënligjore, që kanë të bëjnë me miratimin e programit dhe të strategjisë së privatizimit të bankës, formula e privatizimit, rikapitalizimi e bankës dhe mbulimi i humbjeve nëpërmjet emetimit të bonove të thesarit, si dhe është miratuar vendimi për procedurat e privatizimit të Bankës së Kursimeve.

Vlen të përmendet që, për herë të parë gjatë dhjetë viteve të fundit, Banka e Kursimeve rezultoi me fitim në vitin 1999 dhe në vijim ka rritur fitimin e saj, gjë që krijon një bazë të shëndoshë për perspektivën e bankës në të ardhmen. Gjithashtu, rikapitalizimi i bankës para përfundimit të procesit të privatizimit të saj (në dallim nga Banka Kombëtare Tregtare, që u rikapitalizua në momentin e privatizimit) krijon një epërsi për bankën dhe e bën atë atraktive për blerësit e huaj.

Nëpërmjet privatizimit të Bankës së Kursimeve, prej investitorëve strategjikë, synohet të rritet efienca dhe fitimi i kësaj banke, por njëkohësisht do të rritet konkurrenca në sistemin bankar, do të përmirësohet ndjeshëm teknologjia dhe do të ofrohen shërbime dhe produkte të reja për klientët, sipas praktikave të bankingut bashkëkohor, të cilat do të rritin reputacionin e bankës dhe besimin ndaj saj.

Në përfundim, nuk mund të mos theksoj se, në sajë të këtyre masave të ndërmarra në vazhdimësi, veçanërisht gjatë këtyre tre viteve të fundit të qeverisjes së mazhorancës socialiste, për reformimin e ekonomisë e të financave, është bërë i mundur konsolidimi fiskal dhe qëndrueshmëria e financave publike, shprehje konkrete e të cilave janë:

- Reduktimi i deficitit buxhetor, në përgjithësi dhe ai që financohet me burimet e brendshme, nga 10.44 për qind që ishte në vitin 1998 në 8.4 për qind për vitin 2002, në sajë të rritjes së të ardhurave nga administrata doganore dhe tatimore dhe administrimi më i mirë i shpenzimeve.
- Ulja e huamarrjes së brendshme e shoqëruar me reduktimin e shpenzimeve për interesat e borxhit, nga 8 për qind e PBB-së në vitin 1998, në 3 për qind për vitin 2002.

- Rritja e shpenzimeve kapitale për investime në masën mbi 20 për qind në vitin 2002 ndaj të pritshmit të vitit 2001, duke arritur kështu shumën 51,5 miliardë lekë, çka dëshmon për hapa të rinj përpara në zhvillimin ekonomik të Shqipërisë.

Ju faleminderit !

LITERATURA DHE REFERIMET

David D. Driseell, "Qu'est-ee que le Fonds Monetaire International", Washington, 1994.

Les cinquante ans de FMN, Madrid, 1974.

M. Michel Camdessus, "Quatre attentions", Les Madrid, 1994.
P.A. Samuelson, "L'Economique", Paris, 1972.

Prof. S. Hilmia, As.Prof. Dr. A. Angjeli, "Financat Publike", Tiranë, 1994.

B.Frizziolti, "Primi elementi di scienza delle finanze", Milano, 1930.
Centre International pour le Developpement Economique, "La reforme fiscale dans le Monde", San Francisko, 1972.

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Tirane, Tetor 1998.

Ligji Nr.7677, datë 03.03.1993, "Për tatimin mbi fitimin", ndryshuar në 1995 dhe 1996.

Ligji Nr.8070, datë 15.02.1996, "Për tatimin mbi vlerën e shtuar",
ndryshuar me Ligjin 8126, datë 09.07.1996.

Ligji Nr. 7786, datë 27.01.1994, "Për tatimin mbi të ardhurat
personale".